

PYJE PËR ASFALT

PYJE PËR ASFALT

PRISHTINË, SHKURT 2020

COPYRIGHT © 2020. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të rezervuara të gjitha të drejtat për këtë raport dhe asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të jetë objekt i riprodhimit ose bartjes në asnjë formë mekanike ose elektronike, duke përfshirë fotokopjimin ose ndonjë sistem të ruajtjes ose tërheqjes së materialeve pa autorizimin paraprak të botuesit me shkrim. Publikimi mund të riprodhohet ose të bartet vetëm për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që ka për qëllim të përdorë fragmente ose materiale të ndryshme të këtij publikimi, është i detyruar ta tregojë qartë burimin sa herë që janë nxjerrë fragmentet ose materialet e përdorura.

Nëse keni ndonjë koment, kritikë ose sugjerim, ju lutemi na kontaktoni përmes ndonjë prej opsioneve të mëposhtme:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +383 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Autor: Diana Metushi Krasniqi

Editor: Edita Mustafa Salihi

Foto: KDI

Faqosja dhe dizajni: envinion

Ky publikim është përgatitur nga Instituti Demokratik i Kosovës – Transparency International Kosova dhe përkrahur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Ky hulumtim është pjesë e Programit Pro Open. Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë publikim nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e KFOS.



Foto@ MF Group – Parku Kombëtar i Sharrit

**“NJË KOMB QË SHKATËRRON
TOKAT E TIJ SHKATËRRON
VETVETEN. PYJET JANË
MUSHKËRITË E TOKËS TONË,
PASTROJNË AJRIN DHE JAPIN
FORCË TË FRESKËT PËR
POPULLIN TONË”**

Theodore Roosevelt

PËRMBAJTJA

HYRJA	8
SFONDI	9
PROBLEMI	10
ÇËSHTJET E IDENTIFIKUARA NË RASTET E ANALIZUARA	12
Gurthyesit në mes vendbanimeve Llabjan dhe Parallovë	12
Gurthyesi Gllama në Gjilan	13
Gurthyesit në Gadime të Poshtme dhe Babush të Muhaxherëve	14
Gurthyesi në Carralevë	15
Gurthyesit në Belincë	16
Gurthyesit në Samadrazhe dhe Studençan	18
Gurthyesi në Zhur	19
Deponia e mbetjeve nga Flotacioni në Kizhnicë	20
Miniera e Feronikelit në Magure, Miniera e Magnezitit në Golesh dhe Gurthyesi në Medvec	21
Skoria nga Miniera e Feronikelit në Drenas dhe Gurthyesi në Cërvadik	22
DEGRADIMI I PYJEVE PËRMES KONTRATAVE PUBLIKE	23
KONKLuzion	25
REKOMANDIMET	26

HYRJA

Pse na duhen pyjet? Pyjet sigurojnë ruajtjen e ujit, evitojnë erozionet e tokës, zbusin ndryshimet klimatike dhe ajo më kryesorja, veprojnë si mushkëritë e planetit duke thithur dioksidin e karbonit dhe duke lëshuar oksigjenin në atmosferë përmes fotosintezës.. Ne varemi nga pyjet për mbijetesën tonë, nga ajri që thithim, për ujin për pije e deri tek druri që përdorim¹. Për më shumë, pyjet janë shtëpi a e rreth 80% të biodiversitetit tokësor në botë, dhe ato gjithashtu përbëjnë burimin e jetesës për shumë vendbanime të ndryshme jetësore².

Rreth 44% e territorit të Kosovës është e përbërë nga pyjet³. E në këto pyje kanë një florë dhe faunë mjaft të gjerë dhe me rëndësi, sidomos duke pasur parasysh se ato përbëjnë rreth 25% të florës së Ballkanit dhe rreth 18% të florës së Evropës⁴. Por përtej bukurive dhe llojllojshmërive të biodiversitetit, Kosova ka nevojë për ajrin e pastër dhe për ujin e pyjeve.

Kosova është në fazën përfundimtare në përmbushjen e zbatimit të Strategjisë dhe Politikave të Pyjeve në nivel kombëtar duke u mbështetur në praktikat e mira të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve si një pasuri natyrore⁵. Megjithatë, po i njëjti raport shpreh shqetësime se Agjencia e Pyjeve e Kosovës nuk po mund të shfrytëzojë kapacitetet pyjore në përmbushjen e nevojave vendore të popullatës dhe komunitetit të biznesit si pasojë e prerjeve të parregullta. Raporte të ndryshme potencojnë se pyjet tona po rrezikohen vazhdimisht nga prerjet ilegale dhe zjarr-vëniet e qëllimshme, të cilat janë me pasoja afatgjata. Por a janë prerjet ilegale dhe zjarr-vëniet rreziku i vetëm ndaj pyjeve tona?

Që nga përfundimi i luftës, industria nxjerrëse kategorizohet si dëmtues tjetër potent i pyjeve të Kosovës. Ndonëse ekziston legjislacioni gjithpërfshirës dhe kryesisht i harmonizuar me atë të BE-së, dhe, praktikat tregojnë se vetëm në 17 rastet e trajtuara⁶ të operatorëve të industrisë nxjerrëse janë shkatërruar mbi 125 hektarë pyje, dhe në asnjërin prej tyre nuk është bërë ripyllëzimi siç kërkohet me ligj. Për më shumë, në rreth 82% të rasteve të trajtuara në këtë raport, nuk janë respektuar dispozitat ligjore për distancën ndërmjet punishteve dhe vendbanimeve, duke shkaktuar ndotje mjedisore dhe akustike, dhe duke rrezikuar shëndetin, jetën dhe mirëqenien sociale të banorëve.

1 Argumentet për ruajtjen e tokës: Dokumentim dhe burime informacioni për mbrojtjen e burimeve të tokës, Fondi për tokat publike, McAlinney, Mike., Sacramento, CA, 1993.

2 Ne duhet të ruajmë pyjet tona, World Wide Fund For Nature 2019,

3 Inventari Nacional i Pyjeve (INP) 2012/2013

4 Profili i Kosovës, MMPH 2004

5 Raporti i Gjellbër, MMPH 2019,

6 Shih rastet e elaboruara më poshtë

SFONDI

Hovi i zhvillimit të tanishëm ekonomik, dhe aktivitetet e njeriut si pjesëmarrës në këtë zhvillim, jo gjithmonë janë në përputhje me normat e mbrojtjes së mjedisit, duke ngjallur shumë shqetësime në shoqëri. Me qëllim të harmonizimit të këtyre aktiviteteve dhe shqetësimeve shoqërore, institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, kishin hartuar strategjinë minerare të Republikës së Kosovës 2012 – 2025⁷. Kjo strategji ka për qëllim parashikimin e zhvillimit në planin afat gjatë të minierave dhe hartimin e ligjeve, akte nënligjore dhe rregulloreve të nevojshme për miniera. Për më tutje, në Strategjinë Minerare 2012-2025 është thënë së zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, social dhe mirëqenia e qytetarëve është prioritet kryesor i institucioneve shtetërore të Kosovës. Kjo strategji e konsideron si shumë të rëndësishme mbrojtjen e mjedisit dhe garanton marrjen e masave të nevojshme për minimizimin e ndikimeve mjedisore të shkaktuara nga aktiviteti minierar. Më tutje, thuhet se kjo strategji krijon mundësi reale për shfrytëzim racional dhe të qëndrueshëm të resurseve minerale dhe përveç tjerash synon vizionin **“Të punohet për mbrojtjen e mjedisit dhe të minimizohen efektet negative”**.

Situata në terren flet për diçka tjetër. Pyjet vazhdojnë të shkatërrohen nga prerjet ilegale, zjarret dhe **gurthyesit**. Është e kuptueshme që zhvillimi ekonomik sjell nevojën e paevitueshme për investime në infrastrukturë, në rrugë, ndërtesa banimi apo në objekte biznesi, por kjo duhet të bëhet konform standardeve mjedisore, e jo duke shkatërruar shtretërit e lumenjve apo gërryer pyjet e kodrat për të siguruar gurë e zhavor.

Duke qenë një aktivitet mjaft i kërkuar, edhe fitimet nga ky biznes i mihjes së xeheve janë mjaft të mëdha. Investimet në rrugë vazhdojnë si prioritet i çdo Qeverie, por edhe si kërkesë që vjen nga vet qytetarët⁸, pa e menduar asnjëherë për koston reale të këtyre ndërtimeve. Raporte vendore dhe ndërkombëtare kishin ngritur shqetësime lidhur me investimet e politizuara në ndërtimin e rrugëve⁹, por edhe në dhënien e lejeve për operimin e gurthyesve¹⁰.

7 Strategjia minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025

8 Procesi i zhvillimit të buxheteve komunale, KDI 2020

9 Raporti i Bankës Botërore për Kosovë, 2010

10 Kapja e shtetit: Ekonomia Politike e Zhavorrit, KDI 2018

PROBLEMI

Kosova sot ballafaqohet me probleme serioze mjedisore, si sasia dhe cilësia e ulët e ujërave, ajri i ndotur¹¹, kontaminimi i tokës, menaxhimi i dobët i mbeturinave, shkatërrimi i pyjeve, derdhja e ujërave të ndotura në lumenj, pesticidet, zjarret, etj. Dhe të gjitha këto probleme, kanë një cak të përbashkët, ndikimin në jetën e botës organike të Kosovës, pasojat në faunë e florë dhe mbi të gjitha në shëndetin e njeriut.

Sipas raporteve të Bankës Botërore, në Kosovë rreth 760 persona përballen me vdekje të parakohshme çdo vit nga ekspozimi ndaj ndotjes së ajrit të ambientit¹². **Shumica e këtyre njerëzve kanë më pak se 70 vjet.** Vdekjet e parakohshme dhe sëmundjet e shkaktuara nga ndotja e ajrit rezultojnë në rritje të shpenzimeve për shëndetësi dhe humbje të produktivitetit të punës, përderisa çmimi ekonomik i lidhur me dëmin shëndetësor nga ndotja e ajrit në Kosovë llogaritet të jetë mesatarisht rreth 240 milionë dollarë amerikan¹³.

Përderisa flasim për ajrin e ndotur, është e pamundur të mos trajtojmë rëndësinë e pyjeve në jetën tonë. Sipas **Dr. Helmenstine**¹⁴ "Një pemë 30 metra, me diametër 50 centimetra, në bazën e saj prodhon rreth 260 kilogram oksigjen çdo vit. Dy pemë të maturuara mund të japin oksigjen të mjaftueshëm për një familje prej katër anëtarësh^{[15][16]}. Por jo vetëm kaq, pemët gjithashtu ruajnë dioksidin e karbonit në fibrat e tyre duke ndihmuar në pastrimin e ajrit dhe të zvogëlojnë efektet negative që ky dioksid karboni (CO₂) mund të ketë pasur në mjedisin tonë.

Sipas Fondacionit Arbor Day, brenda një viti një pemë e maturuar do të thithë më shumë se 22 kilogram dioksid karboni nga atmosfera dhe do të lëshojë oksigjenin në këmbim¹⁷.

Sipas raportit të gjendjes së natyrës, në Kosovë, gjatë periudhës 2015-2017 në mënyrë ilegale është prerë një sasi e drunjve prej 48,243.35 m³¹⁸. Megjithatë, deri më tani në Kosovë, nuk ka të dhëna për hapësirën e shkatërruar të pyjeve, sidomos nga fushë veprimtaria e gurthyesve.

Në Kosovë, sot operojnë mbi 200 gurthyes, të cilët po kontribuojnë në degradimin e mjedisit, edhe pse mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit gjatë hulumtimit, shfrytëzimit dhe përpunimit të resurseve minerare duhet jetë një nga qëllimet kryesore dhe do të garantohet me legjislacion, rregulla dhe kufizime të rrepta, sipas standardeve të BE-së. Sipas ligjit për Miniera dhe Minerale, pasuritë minerale duhet të shfrytëzohen në dobi të komunitetit, por njëkohësisht në respekt të plotë të mirëqenies së individit, nëpërmjet mbrojtjes së mjedisit dhe rehabilitimit të tij.

Fenomenet negative si pasojë e shfrytëzimit në minerar shfaqen me hapjen dhe zhvillimin e minierës, andaj institucionet duhet të kërkojnë që subjektet e licencuara për shfrytëzim të trajtojnë këto degradime mjedisore në vazhdimësi. Subjekteve të licencuara duhet t'u kërkohej të bëjnë projektin për efektet negative në mjedis¹⁹, masat parandaluese që duhet të ndërmerren gjatë aktivitetit minerar edhe pas mbylljes së minierës deri në dorëzimin

11 Menaxhimi i ajrit të ndotur në Kosovë, Banka Botërore, 2019

12 Deklaratë e Marko Mantovanelli, Drejtor i Bankës Botërore për Kosovë, për OnAir RTK-Radio 10.02.2020

13 "Menaxhimi i ndotjes së ajrit në Kosovë", Banka Botërore, Tetor 2019

14 Anne Marie Helmenstine, Ph.D.

15 Sa oksigjen prodhon një pemë?, Anne Marie Helmenstine, Ph.D., Nëntor 2019 (e qassur me 2/24/2020),

16 Sa pemë duhet për të prodhuar oksigjen për një person?, Villazon, Luis, BBC Science Focus Magazine

17 Fuqia e një peme – Vet ajri që ne thithim, Departamenti i Agrikulturës i SH.B.A-së, Qershor 2019 (e qassur me 2/24/2020)

18 Raporti për gjendjen e natyrës 2015 – 2017, AMMK 2019

19 Ligji Nr. 03/L-214 për vlerësimin e ndikimit në mjedis

e minierës²⁰. Në vazhdim, ligji parasheh se është obligim i bartësit të së drejtës minerare që të angazhohet me komunitetin dhe grupet e interesit, për të marrë pajtimin e tyre paraprak në bazë të interesave reciproke, për shembull në rastin e zhvendosjes së komuniteteve nga zonat e ardhshme të shfrytëzimit dhe rehabilitimin e minierave, si sipërfaqësore ashtu edhe ato nëntokësore. **Kjo përfshin edhe obligimin e ri-kultivimit të lokacioneve ku është bërë përpunimi i xeheve në të kaluarën, me anë të procedurave standarde mjedisore dhe vlerësimit të koston.**

Kjo analizë vë në pah aktivitetet minerare të mostrës prej 17 gurëthyesve dhe minierave të cilët operojnë në Kosovë, të cilat shpërfaqin një gjendje alarmante mjedisore, gjithashtu me ndikim të theksuar në jetën e qytetarëve të cilët jetojnë në afërsi të zonave të mihjes.

**“AJO QË NE PO U BËJMË
PYJEVE TË BOTËS ËSHTË
VEÇSE NJË PASQYRIM I ASAJ
QË NE PO IA BËJMË VETES DHE
TË TJERËVE”**

Mahatma Gandhi

20 Ligji Nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet

RASTET E STUDIMIT DHE GJETJET

GURTHYESIT NË MES VENDBANIMEVE LLABJAN DHE PARALLOVË

Rruga rajonale Prishtinë - Gjilan është e njohur për rreziqet në komunikacion, dhe numrin e madh të aksidenteve, shumë prej tyre edhe me fatalitete. Përveç trasës me shumë kthesa, kjo rrugë kalon ndërmjet dy gurthyesve, të cilët ushtrojnë aktivitetet e tyre në një sipërfaqe prej rreth 15 hektarësh dhe përbëjnë pengesë në qarkullimin e automjeteve. Këta Gurthyes gjatë tërë veprimtarisë së vet ka qenë pengesë për komunikacionin në këtë rrugë dhe rrezik për qarkullimin e automjeteve²¹.

Për fat të mirë, në afërsinë të gurthyesve nuk ka vendbanime. Megjithatë, këta gurthyes nuk kanë bërë ri-kultivimin e sipërfaqes tashmë të shfrytëzuar, siç e kërkon ligji për miniera, dhe për t'i dhënë kohë të mjaftueshme që bimët dhe pemët e mbjella të rriten. Në mungesë të zbatimit të ligjit kjo sipërfaqe ka mbetur e zhveshur.




Foto 1. Gurthyesit në mes vendbanimeve Llabjan dhe Parallovë, 02/26/2020, foto nga Google Earth

21 Raporti për Komunat, FIQ, 2017

GURTHYESI NË GLLAMË NË GJILAN

Gurthyesi në Gllamë ndodhet në periferi të Komunës së Gjilanit. Në afërsi të këtij gurthyesi gjenden shtëpi, të cilat kanë qenë të ndikuara nga zhurma e eksplozivëve dhe mekanizmit të minierës, ndotja e ajrit etj. Gurthyesi Gllama e ka një sipërfaqe prej rreth 30 Hektarësh, dhe sikurse edhe në rastin paraprak, ky gurthyes nuk ka bërë rekultivimin e sipërfaqes tashmë të shfrytëzuar. Për më shumë, në territorin ku ushton veprimtarinë ky gurthyes, shtëpia më e

afërt është vetëm 103 metra larg nga vend-punishtja, e që është në kundërshtim me ligjin për minierat dhe mineralet, sipas të cilit këto veprimtari nuk do të ushtrohen në ndonjë sipërfaqe që ndodhet më afër se dyqind (200) metra nga kufiri i një fshati, qyteze, qyteti apo vendbanimi tjetër, 100 metra nga ndonjë shtëpi apo ndërtesë, dhe 45 metra nga një tokë bujqësore²².




Foto 2. Gurthyesi Gllama, Gjilan, 02/26/2020, foto nga Google Earth

²² Ligji Nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, neni 13

GURTHYESIT NË GADIME TË POSHTME DHE BABUSH TË MUHAXHERËVE

Gurthyesi në Gadime të Poshtme, veprimtarinë minerare e ushtron shumë afër fshatit, ku shtëpia më e afërt është në një distancë prej 40m, e që është në kundërshtim me ligjin për minierat dhe mineralet. Nga ky Gurthyes është i ndikuar pothuajse i gjithë fshati, nga zhurma e shpim-plasjeve të eksploziveve, nga zhurma e mekanizmit të Gurthyesit, nga ndotja e ajrit, etj. Gurthyesit në Gadime të Poshtme dhe Babush të Muhaxherëve kanë një sipërfaqe prej rreth 52 Hektarësh, dhe edhe në këtë rast, hapësirat ku aktivitetet e mihjes janë përfunduar, nuk është bërë rikultivimi i sipërfaqes. Në vazhdim, 40 metra në afërsi të këtyre gurthyesve ka toka bujqësore, ku sipas ligjit këto aktivitete duhet të jenë së paku 45 metra larg²³.

Për shkak të rëndësisë dhe potencialit turistik të këtij rajoni, ku edhe shtrihet Shpella e Gadimes, një atraksion natyror i Kosovës, në vitin 2005 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kishte marr një vendim për mbrojtjen e këtij territori, duke ndaluar çdo lloj aktiviteti në një perimetër prej 3 kilometra përreth shpellës, ndërsa në vitin 2016 Qeveria kishte vendosur ta shpallte këtë pjesë si zonë të mbrojtur²⁴. Megjithatë, në vitin 2017, qeveria kishte anuluar vendimin paraparak për Zonën e Gadimës²⁵ për shkak të referencave të gabueshme ligjore, por nuk kishin marr një vendim të tjetër i cili do të përmirësonte gabimet²⁶, dhe do ta mbronte këtë zonë, duke e lënë atë në rrezik nga gurthyesi.




Foto 3. Gurthyesit në Gadime dhe Babush të Muhaxherëve, 02/26/2020, foto nga Google Earth

23 Ligji Nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, neni 13 (këto veprimtari nuk do të ushtrohen në ndonjë sipërfaqe që ndodhet më afër se dyqind (200) metra nga kufiri i një fshati, qyteze, qyteti apo vendbanimi tjetër, 100 metra nga ndonjë shtëpi apo ndërtesë, dhe 45 metra nga një tokë bujqësore)

24 Vendimi i Qeverisë 05/71 i datës 22.01.2016

25 Vendimi i Qeverisë 25/20 i datës 20.12.2017

26 Gabimi në vendimin paraparak ishte referenca në dispozitë të gabuar ligjore. Sipas AMMK, nuk kanë informata se përse Qeveria nuk kishte miratur ende përmirësimin e këtij gabimi referues (6 mars 2020)

GURTHYESI NË CARRALEVË

Edhe Gurthyesi në Carralevë veprimtaritë minerare nuk i kryen në përputhje me ligjet dhe normat në fuqi. Shtëpia më e afërt është në distancë 108m. Lumi Carraleva përveç që është i ndotur nga ujërat e zeza të derdhura nga shtëpitë përskaaj, ndotet edhe nga aktivitetet e veprimtarive minerare të këtij gurthyesi në formën e pluhurave dhe vajrave të mirëmbajtjes së makinerisë. Në vazhdim, ky gurthyes është përcjell edhe me ndikime sociale si rezultat i zhurmës të shpim-plasjeve të eksploziveve, nga zhurma e mekanizmit të minierës – Gurthyesit, ndotjes së

ajrit, rrezikimin e trafikut etj. Banorët e Carralevës kanë protestuar disa herë gjatë dekadës së fundit lidhur me shqetësimet e shkaktuara nga kjo veprimtari minerare. Ata madje kishin organizuar edhe një debat me Komunën e Shtimës²⁷ për shqetësimet sociale por edhe dëmet mjedisore nga aktivitetet e gurthyesve në këtë rajon, megjithatë aktiviteti i tyre nuk ishte ndalur. Ky gurthyes ka mihur një sipërfaqe prej rreth 14 Hektarësh, në përgjithësi tokë pyjore, dhe në asnjërën pjesë të aktiviteteve të përfunduara nuk ka bërë rikultivimin e hapësirës së mihur.




Foto 4. Gurthyesi në Carralevë, 02/26/2020, , foto nga Google Earth

²⁷ Debat i organizuar me datën 23 mar 2016

GURTHYESIT NË BELINCË

Në fshatin Belinc, të komunës së Shtimes, operojnë dy gurthyes. Përderisa në perimetrin e gurthyesit të parë nuk ka shtëpi banimi apo toka bujqësore, përmes të këtij Gurthyesi kalon lumi Carraleva dhe rruga rajonale që e lidhë Shtimen me Suharekën. Ky gurthyes, përveç që ndot lumin, rrezikon edhe pjesëmarrësit në komunikacion nga aktivitetet minerare si shpim-plasja me eksploziveve, dhe transportimi i gurëve. Ky gurthyes ka një sipërfaqe prej rreth 13 Hektarëve dhe sikurse në rastet e më sipërme, edhe në këtë rast nuk është bërë rekultivimi i sipërfaqeve të përfunduara nga veprimtarit minerare të Gurthyesit, me ç' rast këto sipërfaqe kanë mbetur të zhveshura. Një shqetësim lidhur me gurthyesin në fjalë është se më territorin ku ushton veprimtarinë janë dy shtëpi banimi brenda territorit të gurthyesit²⁸.

Edhe Gurthyesi i dytë në Belincë, veprimtarinë minerare nuk e kryen në harmoni me ligjet dhe në mënyrë profesionale. Në afërsi të këtij Gurthyesi ka vendbanim në tërë shtrirjen e tij, e që drejtë për drejtë rrezikohet nga veprimtaritë minerare. Shtëpia ma e afërt me Gurthyesin është rreth 30m²⁹. Po ashtu përskaaj në afërsi të këtij Gurthyesi kalon lumi Carraleva dhe rruga rajonale që e lidhë Shtime – Suharekë. Ky Gurthyes, përveç që ndot lumin, rrezikon nga mihjet dhe erozionet e mundshme edhe dy shtëpitë e banimit brenda hapësirës së gurthyesit, si dhe rrezikon kalimtarët e rastit dhe mjetet e komunikacionit në rrugë. Ky gurthyes ka një sipërfaqe prej rreth 6 Hektar, dhe për shkak të mihjeve jo profesionale, nuk janë krijuar as mundësitë e rikultivimit të hapësirës së mihur. Në vazhdim, ky gurthyes vepron në mënyrë ilegale përkundrejt kallëzimeve penale të deponuara nga KPMM.




Foto 5. Gurthyesi në Belincë, 02/26/2020, foto nga Google Earth

28 Ligji Nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, neni 13

29 Ligji Nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, neni 13

|||||




Foto 6. Gurthyesi në Belincë, 02/26/2020, foto nga Google Earth

|||||

GURTHYESIT NË SAMADRAZHË DHE STUDENÇAN

Edhe Gurthyesit në Samadrazhe dhe Studençan, veprimtarinë minerare e kanë të ngjashme me Gurthyesit e përshkruara më parë. Në afërsi të këtyre Gurthyesve ka vendbanime, që drejtë për drejtë rrezikohen nga veprimtaritë minerare. Shtëpia më e afërt me këta Gurthyes është rreth 50m. Këta Gurthyes, kanë ndikim në ndotjen e mjedisit por edhe rrezikojnë nga shpim-plasja me eksploziveve, kalimtarët e rastit dhe mjetet e komunikacionit në rrugë. Gurthyesit kanë sipërfaqe prej rreth 41 Hektar. Nga ana tjetër aktivitetet minerare të këtyre gurthyesve kanë ndikim në ndotjen e ajrit, krijimin e zhurmës nga puna e mekanizmit

të Gurthyesit si dhe rreziqet tjera, si dhe nuk është bërë rekultivimi i sipërfaqeve të përfunduara nga veprimtaritë minerare të Gurthyesit. Edhe në këtë rast, në territorin ku ushtron veprimtarinë ky gurthyes, shtëpia më e afërt është vetëm 50 metra larg nga vend-punishtja, e që është në kundërshtim me ligjin për minierat dhe mineralet, sipas të cilit këto veprimtari nuk do të ushtrohen në ndonjë sipërfaqe që ndodhet më afër se 200 metra nga kufiri i një fshati, qyteze, qyteti apo vendbanimi tjetër, 100 metra nga ndonjë shtëpi apo ndërtesë, dhe 45 metra nga një tokë bujqësore³⁰.




Foto 7. Gurthyesit në Samadrazhe dhe Studençan, 02/26/2020

30 Ligji Nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, neni 13

GURTHYESI NË ZHUR

Sikurse edhe në rastet e më sipërme, gurthyesi në Zhur, veprimtarinë minerare e ka të ngjashme me gurthyesit e përshkruara ma parë. Në afërsi të këtij gurthyesi ka vendbanime, që drejtëpërdrejtë rrezikohen nga veprimtaritë minerare. Ky gurthyes, ka ndikim në ndotjen e mjedisit por edhe rrezikon nga shpim-plasja me eksploziveve, kalimtarët e rastit dhe mjetet e komunikacionit në rrugë. Gurthyesi ka një sipërfaqe prej rreth 41 Hektar. Nga ana

tjetër aktivitetet minerare kanë ndikim në ndotjen e ajrit, krijimin e zhurmës nga puna e mekanizmit të Gurthyesit si dhe rreziqet tjera, si dhe nuk është bërë rikultivimi i sipërfaqeve të përfunduara nga veprimtaritë minerare të gurthyesit. Për më shumë, në territorin ku ushton veprimtarinë ky gurthyes, shtëpia më e afërt është vetëm 46 metra larg nga vend-punishtja, e që është në kundërshtim me ligjin për minierat dhe mineralet³¹.




Foto 8. Gurthyesi në Zhur, 02/26/2020, foto nga Google Earth

31 Ligji Nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, neni 13

DEPONIA E MBETJEVE NGA FLOTACIONI NË KISHNICË

Deponia e mbetjeve nga Flotacioni në Kishnicë është lokacion i mbushur me mbetje nga mineralet e Plumbit dhe Zinkut. Ujërat e ndotura nga deponia e Flotacionit vazhdojnë të rrjedhin në sasi të zvogëluar, në tip të përrockës, në drejtim të vendbanimit Graçanica, dhe më pastaj derdhen në lumin Graçanka. Këto ujëra nuk trajtohen në asnjë formë dhe si të tilla notin tokën, pusët e shtëpive e vend-

banimeve që gjenden për rreth kësaj deponie. Po ashtu, sipas legjislacionit në fuqi, edhe në rastin e kësaj deponie është dashur të bëhet rekultivimi i saj, me ç' rast 47 hektarë tokë kanë mbetur të zhveshura. Në vazhdim, në territorin shtëpia më e afërt me këtë deponi është vetëm 30 metra dhe kufizohet me toka bujqësore, e që është në kundërshtim me ligjin për minierat dhe mineralet³².




Foto 9. Deponia e mbetjeve nga Flotacioni në Kishnicë, 02/26/2020, foto nga Google Earth

32 Ligji Nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, neni 13

MINIERA E FERONIKELIT NË MAGURE, MINIERA E MAGNEZITIT NË GOLESH DHE GURTHYESI NË MEDVEC

Miniera e Feronikelit është minierë e prodhimit primar të mineralit të Hekurit (He) dhe Niklit (Ni). Xehja e cila nxirret nga punimet sipërfaqësore më pastaj dërgohet në Shkri-toren e Feronikelit në Drenas ku përfitohet Feronikeli. Gjatë nxjerrjes së xehes paraqiten ujërat, të cilat ndoten dhe ato patjetër duhet të nxjerrën jashtë nga miniera e Feronikelit. Këto mbetje derdhen në Magure, dhe më pas ato derdhen në lumin e Sitnicës pa asnjë lloj të tra-jtimit. Gjatë rrjedhës, këto ujëra ndotin tokën dhe pusët e shtëpive e vendbanimeve që gjenden përrreth rrjedhës së lumit. Për dallim nga rastet tjera, kjo minierë ka bërë rikultivimin e një pjese të sipërfaqes së shfrytëzuar,

Në vazhdim, tek Miniera e Magnezitit në Golesh, nga sipërfaqja e shfrytëzuar për mihje, kanë rezultuar rreth 60 hektarë të zhveshur, të cilët nuk janë rikultivuar pas përfundimit të aktivitetit në atë pjesë. Në po të njëjtin ter-ritor gjendet edhe Gurthyesi në afërsi të fshatit Medvec, dhe me aktivitetet e veta si shpim-plasja me eksplozive, ngarkimi dhe transporti i lëndës nga gurthyesi, pluhuri, zhurma, ndërrimi i vajrave të mekanizmit të gurthyesit ka një ndikim shumë të madh social dhe mjedisor në fshatin Medvec. Gjithashtu, në territorin ku ushtrohen këto vep-rimtari minerare shtëpia më e afërt me është vetëm 50 metra dhe në kufi me toka bujqësore³³.



Foto 10. Miniera e Feronikelit në Magure, Miniera e Magnezitit në Golesh dhe Gurthyesi në Medvec, 02/26/2020, foto nga Google Earth

33 Ligji Nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, neni 13

SKORIA NGA MINIERA E FERONIKELIT NË DRENAS DHE GURTHYESI NË CËRVADIK

Skoria nga Miniera e Feronikelit është mbetje e deponuar në afërsi të lumit Drenica. Xehja e cila nxirret nga punimet sipërfaqësore të minierës së Feronikelit në Drenas, më pastaj dërgohet në Shkritoren e Feronikelit në Drenas ku përfitohet metali i Feronikelit dhe nga procesi teknologjik ndahet skoria si mbetje e këtij procesi. Gjatë nxjerrjes së xehes me shfrytëzim sipërfaqësor, paraqiten ujërat, të cilat ujëra ndoten dhe ato patjetër duhet të nxjerrën jashtë nga miniera e Feronikelit në Drenas. Gjithashtu edhe ujërat që janë pasojë të reshurave atmosferike, përmes deponisë së skories, direkt rrjedhin në lumin Drenica pa ndonjë trajtim të tyre.

Në ndërkohë, Gurthyesi që është në afërsi të fshatit, me aktivitetet e veta si shpim-plasja me eksplozive, ngarkimi dhe transporti i lëndës nga gurthyesi, pluhuri, zhurma, ndërrimi i vajrave të mekanizmit të gurthyesit ka një ndikim shumë të madh në mjedisin e fshatit. Shtëpia më e afërt është 154 metra distancë, dhe në perimetrin e saj kufizohet me toka bujqësore³⁴.

Përderisa tek Skoria e Feronikelit ka aktivitete të rikultivimit të sipërfaqes, gurthyesi ka lënë 29 hektarë të zhveshura komplet.




Foto 11.


³⁴ Ligji Nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, neni 13

DEGRADIMI I PYJEVE PËRMES KONTRATAVE PUBLIKE

Sipas raporteve vjetore të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) për vitet 2016 deri në vitin 2018, inspektorët e KPM kanë bërë mesatarisht 1,650 vizita për vit në terren. Këto vizita kanë rezultuar në depozimin e 208 kallëzimeve penale për mihje ilegale nga

operatorët e caktuar. **Një nga shqetësimet kryesore nga këto raporte është se përkundër kallëzimeve penale, mungesa e dënimeve konkrete nga organet e drejtësisë për këta operatorë ka rezultuar vetëm në rritjen e operuesve ilegal.**

AKTIVITETET INSPEKTUESE TË KPMMSË



Por, pse këto informata janë të rëndësishme për problemin me gurthyes?

Gjatë viteve 2017-2019, 50 institucione lokale dhe qendrore të Kosovës kishin nënshkruar mbi 660 kontrata për investime publike në asfaltimin e rrugëve dhe shtrim me zhavorr në Kosovë³⁵. Vlera monetare e këtyre kontratave ishte një miliard Euro³⁶.

Në të gjitha këto kontrata ndër tjera është kërkuar furnizimi me gurë, respektivisht me zhavorr, e që ky furnizim bëhet nga gurthyesit lokal. **Vetëm në 11 gurëthyesit e trajtuar më sipër, gjatë periudhës 2016 – 2019, tetë prej tyre kanë përfituar mbi 220 milion euro kontrata publike³⁷.**

KDI kishte bërë një anketë³⁸ me një mostër prej 15 institucioneve publike që kishin dhënë kontrata për ndërtim të rrugëve, dhe në asnjërin rast, si pjesë e kontratës nuk ishte kërkuar nga operatorët të dëshmojnë politikat për mbrojtjen e mjedisit duke marr parasysh edhe dëshminë se furnizimi me gurë nuk ishte nga gurthyes që vepronin ilegalisht. Për më shumë, këto kontrata nuk kishin një vlerësim të ndikimit në mjedis siç kërkohet nga ligji për mbrojtjen e mjedisit³⁹. Në bazë të përgjigjeve të pranuara nga institucionet publike të anketuara, për shkak të mungesës së njohurive, si dhe në mungesë të udhëzimeve të qarta se si duhet vepruar institucionet në rastet e investimeve kapitale, vlerësimi i ndikimit në mjedis bëhet vetëm kur projektet janë të financuara nga ndonjë institucion i huaj, por jo edhe nga buxheti i Kosovës. Për më tutje, të gjitha këto kontrata kishin dispozita si për gjurmime ashtu edhe për inspektime të gjurmimeve gjatë realizimit të punëve.

Rrjedhimisht, KDI gjatë këtij hulumtimi kishte gjetur se disa nga kallëzimet penale të ngritura nga KPMM gjatë vitit 2019 ishin për veprimtari ilegale të ekstraktimit të gurit për implementimin e kontratave publike të dhëna nga komunitet apo institucione të tjera⁴⁰. **Edhe pse KPMM kishte ndarë shqetësimet për gjurmime ilegale me institucionet publike që kishin lidhur këto kontrata, ato ishin injoruar nga institucionet.** Gjithashtu, edhe organet e drejtësisë ende nuk kishin ngritur aktakuza për të ndëshkuar këto veprime ilegale me ndikim mjedisor, që po shërben si një shtytës që këto aktivitete të vazhdojnë. Gjatë punëtorisë së KDI⁴¹ të mbajtur me akterë të ndryshëm në përfaqësim të institucioneve publike në nivel të autoriteteve kontraktuese, por edhe atyre mbikëqyrëse, të drejtësisë, shoqërisë civile, mediave, etj., ishte shpërfaqur problemi i mungesës së njohurisë nga institucionet publike ndaj zbatimit të kushteve të përgjithshme⁴² të kontratave publike.

Kontratat publike, në pjesën e kushteve të përgjithshme, tek obligimet e kontraktuesit, specifikojnë se **“Kontraktuesi duhet t’i respektojë dhe të veprojë sipas TË GJITHA LIGJEVE DHE RREGULLOREVE NË FUQI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t’i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve”!**

Megjithatë praktikata kanë dëshmuar se as autoritetet kontraktuese dhe as operatorët ekonomik nuk kuptojnë peshën e kësaj dispozite detyrimore, si dhe nuk ka ndonjë udhëzues administrativ që përcakton procedurat dhe përgjegjësitë e palëve të kontratës në raport me mbrojtjen e mjedisit, para, gjatë dhe pas realizimit të punëve.

35 E-Prokurimi (njofitimet e kontratave të nënshkruara për ndërtim të autostradave, asfaltim, ndërtim dhe shtrim me zhavorr të rrugëve lokale dhe regionale për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019)

36 E-Prokurimi (vlerat e kontratave të nënshkruara për ndërtim të autostradave, asfaltim, ndërtim dhe shtrim me zhavorr të rrugëve lokale dhe regionale për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019)

37 Informatat e mbledhura nga platforma Prokurimihapur.org

38 Përgjigjet e pranuara ndërmjet datave – 23 dhe 26 shkurt 2020

39 Ligji Nr. 03/L-214 për vlerësimin e ndikimit në mjedis – Shtojca 1, Pjesa 6. Infrastruktura e transportit

40 Rruga Gjakovë Dolc (Ministria e Infrastrukturës), Ndërtimi i rrugëve në Komunën e Gjiçanit, Rregullimi i shtratit të lumit Ibër, Ndërtimi i Qarkores, vazhdimi i rrugës Bujar Roka.

41 Punëtorja e mbajtur me 16-17 nëntor 2019, në Durrës, Shqipëri

42 Ligji Nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, Kreu VII. Kushtet e përgjithshme të kontratës

KONKLUZIONE

Në 20 vitet e fundit, synimet për zhvillim ekonomik në Kosovë kanë rritur kërkesën për përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe për ndërtime të shumta. Për të plotësuar këto nevoja të tregut, zhvillimi i aktiviteteve minerare, mes tyre edhe nxjerrja e gurit ishte i pashmangshme. Duke qenë mjaft fitimprurëse, industria nxjerrëse (mihëse) vazhdon të jetë mjaft joshëse për bizneset vendore. Për aq sa po ndihmon në zhvillimin ekonomik, sidomos në infrastrukturë, kjo industri po ndikon në degradimin e mjedisit dhe përkeqësimin e shëndetit publik.

Vetëm në 17 rastet e trajtuara më sipër, janë mihur mbi 431 hektarë, nga të cilat mbi 125 hektar pyje janë degraduar totalisht, dhe përkundrejt kërkesave ligjore, ato nuk po ri-kultivohen.

Rastet e studimit tregojnë se këto aktivitete minerare zhvillohen në distanca shumë të vogla me shtëpitë e banimit, tokat bujqësore, përkaj lumenjve e në rrugë rajonale, duke rrezikuar mirëqenien, shëndetin dhe ekonominë e qytetarëve që jetojnë afër tyre apo frekuentojnë këto pjesë.

Vetëm gjatë tre viteve të fundit (2017-2019) Institucionet publike të Kosovës kanë dhënë kontrata publike në vlerë prej një miliard euro. Rreth 220 milion euro janë dhënë për kontrata (punë), të cilat janë për aktivitete të gurëthyesve – shtatë prej të cilave janë përfshirë në këtë analizë.

Asnjë nga 15 autoritetet kontraktuese të anketuara nga KDI, të cilat kishin dhënë kontrata për ndërtime të rrugësh gjatë viteve 2017-2019, nuk kishin të inkuorpuara në kontratat për ndërtim të rrugëve Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) si dhe në mungesë të njohurive rreth kushteve të përgjithshme të kontratës, nuk kishin kërkuar nga operatorët që në kontratat e tyre të kishe një plan për mbrojtjen e mjedisit para, gjatë dhe pas aktivitetit nxjerrës.

Edhe pse Kosova ka një bazë ligjore për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe për mbrojtjen e mjedisit, fatkeqësisht këto ligje nuk po aplikohen në praktikë, dhe rrjedhimisht edhe vet institucionet publike po kontribuojnë në degradimin e mjedisit duke mos siguruar mbrojtjen e tij përmes investimeve kapitale publike. Kjo për shkak se Autoritetet Kontraktuese nuk posedojnë me njohuritë dhe udhëzimet zyrtare se di duhen të zbatohen në praktikë kushtet e përgjithshme në obliguara nga ligji për marrëdhëniet e detyrimeve, si dhe kushtet e përgjithshme të kontratave publike! Për më shumë, Autoritetet Kontraktuese, duke mos u përfshirë në verifikimin e prejardhjes së materialit minerar, nuk kishin ndërmarr asnjë masë ndëshkuese kundrejt operatorëve ekonomik të papërgjegjshëm.

Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve gjatë po të së njëjtës periudhë kishte deponuar në prokurori mbi 200 kallëzime penale për veprimtari ilegale të gurëthyesve. Gjatë analizimit të kallëzimeve penale të deponuara gjatë vitit 2019, ishte gjetur se disa prej tyre ishin lidhur me ekzekutimin e kontratave publike për ndërtim të rrugëve publike. Në të gjitha këto raste, autoritetet kontraktues kishin qëndruar të heshtura kundrejt shqetësimeve të shprehura nga KPMM.

REKOMANDIMET

- 1 Duke pasur parasysh mungesën e njohurive institucionale rreth zbatimit të kushteve të përgjithshme të kontratave publike, Zyra e Kryeministrit duhet të angazhohet në hartimin e një udhëzuesi administrativ si të adresohen dhe mbikëqyren këto kushte, si dhe të definohen përgjegjësitë e palëve në marrëdhënie detyimore;
- 2 Duke pasur parasysh gamën e gjerë të fushë-veprimtarive institucionale dhe numrin e madhe të dokumenteve ligjore, Zyra e Kryeministrit duhet të angazhohet të përpiloj një listë të të gjitha ligjeve dhe neneve që përfshihen në kushtet e përgjithshme të kontratave publike "Kushtet e Përgjithshme", si dhe të siguroj mekanizma të cilët përditësojnë listën në bazë të përditësimeve ligjore;
- 3 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të inkorporoj si pjesë të legjislacionit listën e kushteve të përgjithshme, në trajtë aneksi, e cila do të jetë pjesë kyçe e Dosjes së Tenderit dhe kontratës publike;
- 4 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të modifikoj legjislacionin aktual duke e bërë të obligueshëm Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe pëlqimin mjedisor për kategoritë ligjore për investime kapitale në fazën e planifikimit, dhe pëlqimet mjedisore të jenë pjesë e kërkesës, ne vijim të deklaratës së nevojave dhe mjeteve;
- 5 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të bëjë të obligueshëm, konform kushteve të përgjithshme, që ofertat për investime kapitale të prezantojnë planin për mbrojtjen e mjedisit, dhe që ky plan të vlerësohet si pjesë e vlerësimit teknik të ofertave;
- 6 Komisioni Rregullativ i Prokurimit publik të modifikoj dispozitat ligjore për menaxhimin e kontratave, dhe të përfshijë kërkesat për verifikimin e prejardhjes së materialit për investime kapitale, dhe inspektimet konform planit për mbrojtjen e mjedisit.
- 7 Organet e drejtësisë të reagojnë në mënyrë më shpejtë në pezullimin e punëve dhe shqiptimin e dënimeve ndaj degradueseve të mjedisit, sidomos ndaj rasteve të lajmëruara nga Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve;
- 8 Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve të angazhohet me operatorët ekonomik në rikultivimin e sipërfaqeve ku kanë përfunduar aktivitetet mihëse, dhe jo kur gurthyesi përfundon plotësisht aktivitetet në vendpunishte, sidomos duke pasur parasysh kohën që i nevojitet pemëve për t'u rritur.
- 9 Ministria e Infrastrukturës dhe Mjedisit të marr një rol proaktiv në mbikëqyrjen dhe inspektimin e punimeve kapitale publike me qëllim të parandalimit të degradimit të mjedisit.

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

630*4(496.51)

Krasniqi, Diana Metushi
Pyje për asfalt / Diana Metushi Krasniqi. -
Prishtinë : Instituti Demokratik i Kosovës, 2020.
- 28 f. : ilustr. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-745-35-2

THIRR

**0800
77 777**

RAPORTO KORRUPSIONIN

**KORRUPSIONI
PAMUNDËSOHET
KUR RAPORTOHET**



KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

